

KLODIANA PEZA

**QASJE E PËRVOJËS SHOQËRORE NDAJ LEKSIKUT SEKTORIAL
TË NGJYRAVE**

Fjalët që emërtojnë ngjyra janë një korpus jo i vogël fjalësh, shndërruar tanimë në “pronë” leksikore të shoqërisë. Ky leksik ka padyshim “rekuizitën” e vet etnografike, sociolinguistike, etj. që mishërohet më së pari në ngjyrat e veshjeve, në kuptimet simbolike që ngjyrat mbartin nga kultura në kulturë, apo në përvojën njerëzore në sektorë të ndryshëm.

Sh. Rrokaj në librin e tij “Filozofi e gjuhës”, kur trajton Humboldin dhe teorinë e tij të antonimisë: *energeia/ergon* mbi gjuhën shprehet: “Qasja që bashkësitë gjuhësore i bëjnë përvojës së tyre me botën ndryshon nga njëra gjuhë te tjetra... bashkësitë gjuhësore me gjuhët e veçanta përcaktojnë vizione e mënyra të ndryshme të të parit të botës”¹. Ndaj, fjalët që emërtojnë ngjyra, si pjesë përbërëse e leksikut gjuhësor të një shoqërie, marrin kuptime tërësisht të ndryshme në kultura dhe tradita të ndryshme.

Meqenëse leksiku është i lidhur ngushtë me njohjen dhe përvojën e shoqërisë, gjuha depërton në botën shpirtërore e shoqërorë, duke krijuar një pasuri të larmishme gjuhësore. Ky fond fjalësh, i mbledhur nga veprimtaria e përditshme e njeriut, mundëson komunikimin jo vetëm midis njerëzve, por edhe midis njeriut dhe kafshës siç ndodh në fushën e blegtorisë (çështje e trajtuar në një tjetër punim).

Kërkimi ynë për fjalësin e ngjyrave është shtrirë në terren. Njohja dhe përvoja shoqërore, formimi kulturor i punonjësve të sektorëve të veçantë ekonomikë është bërë objekt i punimit tonë. “Gjuha është dëshmia më e plotë e pasqyrimit të vetëdijes kolektive e individuale... Ajo është strehë e qenies dhe njerëzit janë fakte gjuhësore, janë copëza dijesh, që faktorizojnë ligjërimet e kushtëzojnë përmbajtjen e tyre”². Parë kështu, duket se shoqëria njerëzore e përdor gjuhën, si çelësin për të shenjuar dhe interpretuar çdo realitet njerëzor. Sa i përgjigjet gjuha shqipe (dhe gjuhë të tjera) zhvillimit të sotëm të teknologjisë?

Parë kështu kërkimi është drejtuar në hetimin e pronës leksikore të gjuhës shqipe në një sektor të veprimtarisë së sotme ekonomike, në sektorin e ljerjeve (makina, banesa apo edhe flokë), pra, është fjala për veçoritë

¹ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës: prej antikitetit deri në kohën e sotme*, “Arbëria”, Tiranë, 2010, f. 91.

² Po aty, f. 232.

leksikore të një varianti sektorial, dhe, si një çështje e pandashme nga kjo, do të trajtohet edhe kompetenca gjuhësore e punonjësve të këtij sektori.

Qasja jonë në këtë fushë ka si qëllim mbledhjen e një sërë fjalëve që shenjojnë ngjyra dhe që mund të interpretohen përmes përvojës së këtij grupi shoqëror. Në këtë hetim jemi përqendruar jo vetëm në “importin” leksikor të ngjyrave, por sidomos në reagimin gjuhësor të punonjësve të këtij sektori. Origjinaliteti që ata shfaqin, është pasqyrë e përvojës dhe kulturës së kësaj bashkësie.

Ky këndvështrim do të na shpjegë në disa përfundime që nuk do të ishin pa interes për sociolinguistikën, siç do të ishin, për shembull, dallimet, për sa i përket masës së zotërimit dhe përdorimit të leksikut sektorial (përcaktuar, pa dyshim, nga masa e njohjes së ngjyrave) midis punonjësve të këtij sektori, nga njëra anë, dhe personave që nuk kanë lidhje me të, në anën tjetër; dallimet që do të vireshin re, gjithashtu në këtë aspekt, midis femrave dhe meshkujve apo edhe ndonjë problem tjetër.

Zhvillimet e mëdha në këtë sektor kanë bërë që punonjësit e tij të kenë zgjeruar e thelluar aq shumë njohjen e tyre në gamën e pamasë të ngjyrave e të nuancave, saqë, siç edhe do të ishte e natyrshme, asnjë gjuhë nuk do ta kishte të mundur t’u përgjigjej aty për aty kërkesave të sektorit. Nga ana tjetër, shkëmbimet midis prodhuesve dhe përdoruesve të bojërave apo ngjyrave nga vende të ndryshme të rajonit, që sot kanë përmasa të jashtëzakonshme, do të shtonin në këtë mes edhe problemin e madh të përkthimit nga njëra gjuhë në tjetrën.

Është e qartë se në kushtet e mungesës së fjalëve marrëdhëniet në këtë sektor do të ishin shumë të vështira, ndaj edhe praktika ka ofruar një zgjidhje shumë të thjeshtë: ngjyrat, më saktë nuancat e tyre, nëpër katalogë shënohen me numra.

Kjo zgjidhje sikur i shkarkon gjuhët nga detyrimi për të përfutur menjëherë fjalët e reja, sikur u jep kohë atyre për të përmbushur këtë boshllëk. A është vërtet kështu?

Për t’i dhënë përgjigje pyetjes, do të sjellim një klasifikim të ngjyrave që përdoren rëndom në disa qendra të ndryshme estetike, kryesisht floktoret apo parukeritë.

Ngjyrat natyrale³:

- 1- E zezë
- 2- Kafe në të zezë
- 3- Gështenjë e errët
- 4- Gështenjë natyrale
- 5- Gështenjë e çelët
- 6- Bionde e errët

³ Përkthimi i ngjyrave është bërë nga ne.

- 7- Bionde natyrale
- 8- Bionde e çelët
- 9- Bionde shume e çelët
- 10- Bionde platin

Ngjyrat gri:

- 1- E zezë në blu
- 2- Gështenjë në gri
- 3- Gështenjë e errët në gri
- 4- Bionde e errët në gri
- 5- Bionde në gri
- 6- Bionde e çelët në gri
- 7- Bionde shumë e çelët në gri
- 8- Ngjyrë hiri

Ngjyrat lajthi:

- 1- Lajthi
- 2- Lajthi e çelët
- 3- Lajthi e ndritur

Ngjyrat e arta:

- 1- Gështenjë natyrale në flori
- 2- Bionde e errët në flori
- 3- E artë (flori)
- 4- Bionde në flori
- 5- Bionde e çelët në flori
- 6- Bionde shumë e çelët në flori
- 7- E verdhë

Ngjyrat mogano⁴:

- 1- E kuqe e errët
- 2- E kuqe e errët në vjollcë
- 3- Gështenjë e çelët në të kuqërremtë
- 4- E kuqe e errët (ngjyrë ndryshku)
- 5- Karotë
- 6- Bionde e kuqe e ndritur

Ngjyrat e kuqe:

- 1- E kuqe në vjollcë
- 2- Gështenjë e çelët në të kuqe
- 3- E kuqe e errët në vishnje
- 4- Gështenjë e çelët në të kuqe natyrale
- 5- Gështenjë e çelët në vjollcë

⁴ Nga Dizionario Compatto Della Lingua Italiana, a cura di Anna Cattana, Maria Teresa Nesci, Zanichelli, f. 770: mogano n.m legno rosso molto pregiato, usato per costruire mobile, "dru i kuq shumë i çmuar, që përdoret për mobilie (përkthimi ynë).

- 6- E kuqe e ndezur

Ngjyrat e bakërta:

- 1- Ngjyrë bakri
- 2- Ngjyrë bakri në të kuqe
- 3- Bionde në bakër
- 4- Ngjyrë karotë
- 5- Bionde në portokalli
- 6- Ngjyrë bronz (përzierje e bakrit me argjendin, si ngjyra)
- 7- E kuqe

Ngjyrat bezhë:

- 1- Bionde në bezhë dhe gri
- 2- Bionde në bezhë
- 3- Bionde e çelët në bezhë

Ngjyrat vjollcë:

1. Ngjyrë vjollcë
2. Vjollcë në të kuqe

Ngjyrat mineral (të ftohta):

1. Grafit⁵
2. Pirite⁶
3. Fluorite⁷

Ngjyrat tropikale (të ngrohta):

1. Ngjyrë kafe
2. Ngjyrë kafe e ndritur
3. Ngjyrë e kuqe
4. Ngjyrë kakao
5. Ngjyrë kafe në flori
6. Ngjyrë kanelle
7. Ngjyrë susami

Ngjyrat natyrale të ndritura:

1. Gështenjë e çelët e ndritur
2. Bionde e errët natyrale e ndritur
3. Bionde natyrale e ndritshme
4. Bionde platin e ndritshme

Ngjyrat e përziera:

1. Blu
2. Argjend
3. Gri e errët
4. E kuqe e errët

⁵ Mineral i zi i përdorur për majën e lapsave.

⁶ Mineral në ngjyrë të verdhë.

⁷ Mineral i përdorur në industri për prodhimin e xhamit.

5. Bakër
6. Patëllxhan

Ky është një katalog ngjyrash, i përkthyer, i firmës “Lisap”, i cili do të na shërbejë për interpretimin sociolinguistik. Në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë katalogë të tillë. Edhe pse marrëdhënia e bartësve dhe përdoruesve të shqipes me rajonin e më gjerë, është më e hapur, ende në këtë sektor të madh të ekonomisë nuk është mundësuar marrja e informacionit në shqip. Teknologjia, risitë e saj në këtë sektor i përhap çdo ditë e më shpejt, por leksiku nuk i përgjigjet këtij zhvillimi të vrullshëm. Në to gjejmë fjalë që në shqip nuk u gjendet gjegjësj, siç është rasti i fjalës-ngjyrë *mogano*. Madje, hera-herës, gjuha jonë nuk i përgjigjet as nuancave apo refleksive. Ndaj, bashkë me produktin, tek ne është importuar edhe njësi shenjuese.

I njëjti fenomen ndodh edhe në gjuhë të tjera, p.sh., në italisht. Katalogu, të cilit i jemi referuar, krijonte boshllëqe për disa ngjyra, si: gold, copper, që nuk e kishin gjithashtu gjegjësen e tyre në këtë gjuhë. Pra, problemi i kapërcen kufijtë e gjuhës,” janë kulturat ato që përkthehen e jo gjuhët”⁸. Detyrë e gjuhës në të tilla “ngërçe” është të shfrytëzojë në maksimum mjetet alternative të leksikut të saj ose jo të saj.

Siç mund të shihet nga katalogu kemi disa seri ngjyrash (13 gjithsej). Seria e parë sjell ngjyrat natyrale (e zezë, gështenjë, e bardhë), për të vazhduar përkatësisht me ngjyrat: gri, lajthi, flori, e kuqe, bakër, bezhë, vjollcë. Njohja njerëzore në këtë fushë leksikore ka nisur me ngjyrat natyrale për të vazhduar përmes thellimit të njohjes me të tjera ngjyra e nuanca. Kjo seri pasohet me një grup të vogël ngjyrash të emëtuara përmes metaforës së vendeve apo objekteve përkatëse, që në këtë sektor dëshmohej si një mjet i fuqishëm shprehës. Të tilla janë ngjyrat tropikale (të ngrohta) dhe ngjyrat minerale (të ftohta).

Çdo seri krahas kodit përmban në përcaktimin e ngjyrës kryesore termat: e çelët, e errët, e ndritur duke sjellë diferencë brenda ngjyrës. Kjo terminologji është e lidhur jo vetëm me pasurinë e bojërave, por edhe më njohjen e thellë të krijuesve e përdoruesve të bojërave. Aftësia krijuese njerëzore ka nevojë për gjuhën, dhe, në këtë sektor, kompetenca gjuhësore e punonjësve të saj krijon lehtësi në komunikim. Megjithatë duhet shtuar se, mënyra e veçantë e të shprehurit të lëndës gjuhësore sektoriale, varet jo vetëm nga kompetenca gjuhësore (që është e ndryshme si për femrat ashtu edhe për meshkujt), por edhe nga mjedisi fizik ku jetojnë, përvoja në këtë fushë, kultura që zotërojnë.

Përdoruesit e leksikut sektorial (parukieret, bojaxhinjtë e banesave dhe të makinave), i përcaktojnë ngjyrat nisur nga kodet e tyre. Falë përvojës ato janë në gjendje t’i përcaktojnë ato vetëm nga ky kod edhe kur mungon ngjyra e shkruar. Një paruki e di se kodit 2 i përgjigjet ngjyra e hirtë, apo numrit 5 i

⁸ A. Riska, *Gramatika e krahasuar*, cikël leksionesh, Tetor, 2011.

përgjigjet ngjyra e kuqe. Njohja dhe përvoja në këtë profesion i kapërcen mundësitë e gjuhës dhe lind në këtë mënyrë problemin e përkthimit. Instinktivisht ata janë në gjendje t'u përgjigjen kodeve me leksikun aktiv popullor, duke dalë kështu jashtë leksikut sektorial. Kështu ndodh me ngjyrën karotë, ndryshk, ndërkohë që varianti sektorial përdor këtë përcaktim: bionde në bakër dhe mahogany.

Një tjetër avantazh i këtij sektori ekonomik, i referohem këtu kryesisht parukerive, është mbulimi i këtij profesioni në pjesën më të madhe nga femrat, pa mohuar natyrisht, rolin e meshkujve. Shoqëria njerëzore ka trashëguar përpos ndarjeve të tjera edhe ndarjen sipas gjinisë: meshkuj e femra. "Ky klasifikim në shoqërinë shqiptare bëhet i dukshëm kur flitet për ndarjen shoqërore të punës. Në shoqërinë shqiptare, ndarja tradicionale e punës është njëkohësisht ndarje shoqërore e të folurit".⁹ Femrat duke qenë më të ndjeshme ndaj modës, veshjes, grimit e kanë më të zhvilluar dhe më të pasur lidhjen me leksikun e këtij sektori. Madje leksiku i tyre i ngjyrave përshtatet lehtësisht në situata e sfera të ndryshme shoqërore, duke e bërë repertorin e tyre verbal tepër fleksibël.

Ky konstatim përforcohet nga një fakt tjetër sa sociolinguistik, aq dhe historik. Aftësia e femrave për të dalluar jo vetëm ngjyrat, por edhe nuancat, reflekset është një çështje e diktuar nga shoqëria, duket si gjenetike për shoqërinë shqiptare. Themi kështu sepse gruaja ka qenë e lidhur me avlëmendin (tekstilet), me veshmbathjen, rrobaqepësinë (stilimin), mobilimin e shtëpisë, ndërkohë që mashkulli shqiptar identifikohet i lidhur me punë që kërkojnë forcë fizike, me shpatën dhe pushkën. Fjalori i meshkujve në këtë sektor është më i ngurtë, më i varfër se fjalori i femrave. Një mashkull mund të përcaktojë saktë ngjyrën, por klasifikimin brenda segmentit të një ngjyre asesi. Për të jeshilja është jeshile, sinonimet e saj në nuanca, si: limon, i preshtë, bojë bare, zhuzhinë janë po kjo ngjyrë.

Sidoqoftë, të gjithë do të ishin dakord me mendimin se gjuha duhet t'u përgjigjet të gjitha zhvillimeve dhe, në faza të caktuara të jetës së vet, gjuha është pasqyrë e niveleve të ndryshme të njohjes njerëzore dhe e përvojave të ndryshme shoqërore.

Mirëpo, zhvillimi i teknologjisë jo vetëm që nuk i përgjigjet tërësisht leksikut aktual në sektorin e sipërpërmendur, por është i dukshëm deficit i krijuar. Kështu në sektorin e lyerjeve të makinave ngjyrat përcaktohen përmes fotospektrit i cili futet jep informacionin për ngjyrën. Edhe në lyerjen e makinave ngjyrat përcaktohen në bazë të kodeve. Edhe pse ngjyrat bazë shkojnë në rreth 30 ato përdoren si pigmente. Ngjyra të tilla si: e zezë, gri e errët, ngjyrë miu, blu (e mbyllur, e hapur), bojëdeti, e kuqe (pastel, mat, me

⁹ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes*: nga dialektologjia te etnografia e të folurit, Bot. II, "Morava", Tiranë, 2009, f. 365.

llak), kafe, jeshile (e hapur, e mbyllur), zhuzhinë, e verdhë, e bardhë, etj., kanë kodin e tyre, madje shoqëritë e prodhimit të automjeteve krijojnë katalogë të veçantë me kodet e ngjyrave. Çdo makinë e ka të shënuar këtë kod.

Hetimi në këtë sektor konstatoi një kontradiktë midis zhvillimit të teknologjisë dhe mungesës së leksikut për ta mbuluar dukurinë ose sendin.

BIBLIOGRAFI

A. Riska, *Gramatika e krahasuar*, cikël leksionesh, Tetor, 2011.

Dizionario Compatto Della Lingua Italiana, a cura di Anna Cattana, Maria Teresa Nesci, Zanichelli, 1996.

SH. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës: prej antikitetit deri në kohën e sotme*, “Arbëria”, Tiranë, 2010.

SH. Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes: nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Bot. II, “Morava”, Tiranë, 2009.

